



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN E DISA ANËTARËVE DHE SEKRETARËVE TË KZAZ-VE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 28.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për lirim dhe emërimin e disa anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 30, neni 31, neni 32, pika 2 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

V Ë R E N

Partia Socialiste e Shqipërisë, bazuar në nenin 32, pika 2, germa "d", të Kodit Zgjedhor, me shkresat nr. 12585, nr.12483 prot., datë 27.06.2019, ka kërkuar:

- lirim të anëtarve të KZAZ nr. 14, z. Armarda Pjetri, zj.Esmeralda Prenga dhe emërim të z. Valentin Bardhoku dhe zj.Vitore Kolaj;

Me shkresën nr. 12493 prot., datë 27.06.2019, sekretari i KZAZ nr. 32, z. Beko Agolli, emëruar kryesisht nga KQZ për arsye objektive ka dhënë dorëheqjen.

Me shkresën nr. 12196 prot., datë 24.06.2019, anëtarja e KZAZ nr. 31, zj. Majvis Kola, emëruar kryesisht nga KQZ për arsye objektive ka dhënë dorëheqjen.

Nr. 914 i Vendimit Data 28.06.2019 e Vendimit Ora 10:00 e Vendimit

Për lirim dhe emërimin e disa anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.



Në listën e shtetasve miratuar nga KQZ me vendimin nr. 140, datë 9.04.2019, pas plotësimit të vakancave të KZAZ me emërimet kryesisht nga KQZ, nuk rezultojnë shtetas të paemëruar me vendbanim në Bashkinë Tiranë.

Në shqyrtim të kërkesave të shtetasve, në përgjigje të njoftimit publik të KQZ-së, por që për shkak të paraqitjes në tejkalim të afatit, nuk janë bërë pjesë e lidhjes 1 të vendimit nr. 140, datë 09.04.2019, rezulton se shtetasi Vangjel Tata me arsim juridik dhe shtetasja Eglantina Ajdini, me vendbanim në Bashkinë Tiranë, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenet 30 dhe 31 të Kodit Zgjedhor për tu emëruar kryesisht z.Vangjel Tata sekretar i KZAZ nr. 32, dhe zj. Eglantina Ajdini anëtare e KZAZ nr. 31.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 30, nenin 31, nenin 32, pika 2 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

V E N D O S I:

1. Të lirojë nga detyra anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve sipas lidhjes 1.
2. Të emërojë anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve sipas lidhjes 2.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

